



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 5, datë 28.04.2025

I mbledhjes së Këshillit të Bashkisë, për muajin prill, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës “Labëria”, mbledhja e radhës.(Ora 10:42)

Marrin pjesë:

- | | |
|----------------------|---------------------|
| 1.Simo Petromilo | 16.Grigor Dede |
| 2.Rajmonda Zoto | 17.Erëmal Arapi |
| 3.Gjergji Nika | 18.Arsen Belaj |
| 4.Myzafer Elezi | 19.Geron Gunbardhi |
| 5.Novrus Rrokaj | 20.Brikena Sika |
| 6.Ervis Moçka | 21.Anisa Ceno |
| 7.Simbol Pazaj | 22.Vjola Xhafaj |
| 8.Illir Aliaj | 23.Ardian Musta |
| 9.Roland Strakosha | 24.Ledja Shollaj |
| 10.Besmir Brahimi | 25.Elpiniki Mërkuri |
| 11.Frosina Qyrdeti | 26.Elca Bezhani |
| 12.Englantina Imeraj | 27.Bujar Osmënaj |
| 13.Marsela Dashi | 28.Shkëlqim Leskaj |
| 14.Liljana Breshani | 29.Aurora Qarri |
| 15.Eneida Vera | |

Mungojnë :

- 1.Brikena Puka
- 2.Vullnet Bilbilaj
- 3.Sokol Kushta
- 4.Endri Hyseni
- 5.Briseida Çakërri

- 6.Edlira Kapllanaj
- 7.Gëzim Çapoj
- 8.Jerina Dervishaj
- 9.Atird Hoxha
- 10.Klodian Xhyheri
- 11.Eglantina Aliaj
- 12.Lorel Canaj
- 13.Edison Kapaj
- 14.Eda Begaj
- 15.Evis Allushi
- 16.Mujo Shakaj
- 17.Liri Dëma
- 18.Dikens Bushaj
- 19.Arjan Isufi
- 20.Anxhela Shenaj
- 21.Refie Laze
- 22.Alta Haluci

Largohen në orën 10:19 anëtarët e këshillit:

z.Gjergji Nika;z.Myzafer Elezi;znj.Eneida Vera;z.Erëmal Arapi;z.Arsen Belaj;z.Besmir Brahimi;z.Geron Gunbardhi.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Mirëmëngjes!

Në sallë janë 23 këshilltarë të Partisë Socialiste . Në mungesë të anëtarëve , kuorumit të pamjaftueshëm , shtyhet mbledhja ditën e nesërme, datë 29 Prill, Ora 10:00.

Mbajti Procesverbalin
Zhaneta Gjika



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 5/1, datë 29.04.2025

I mbledhjes së Këshillit të Bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës “Labëria”. Mbledhja e radhës për muajin prill, e cila nuk u zhvillua në datën 28 Prill për mungesë kuorumi, zhvillohet sot në datën 29 Prill. (Ora 10:10)

Marrin pjesë:

- | | |
|---------------------|----------------------|
| 1.Simo Petromilo | 22.Alir Aliaj |
| 2.Simbol Pazaj | 23.Elpinqi Mërkuri |
| 3.Shkëlqim Leskaj | 24.Rajmonda Zoto |
| 4.Ervis Moçka | 25.Vjola Xhafaj |
| 5.Novrus Rrokaj | 26.Edlira Kapllanaj |
| 6.Gëzim Çapoj | 27.Englantina Imeraj |
| 7.Bujar Osmënaj | 28.Besmir Brahimi |
| 8.Vullnet Bilbilaj | 29.Arsen Belaj |
| 9.Frosina Qyrdeti | 30.Grigor Dede |
| 10.Ledja Shollaj | 31.Eda Begaj |
| 11.Ardian Musta | 32.Eneida Vera |
| 12.Roland Strakosha | 33.Geron Gunbardhi |
| 13.Jerina Dervishaj | 34.Brikena Puka |
| 14.Myzafer Elezi | 35.Anisa Ceno |
| 15.Sokol Kushta | 36.Mujo Shakaj |
| 16.Edison Kapaj | 37.Klodian Xhyheri |
| 17.Elca Bezhani | 38.Liri Dëma |
| 18.Brikena Sika | |
| 19.Eglantina Aliaj | |
| 20.Lorel Cana | |
| 21.Gjergji Nika | |

Mungojnë :

- 1.Liljana Breshani
- 2.Endri Hyseni
- 3.Briseida Çakërri
- 4.Aurora Qarri
- 5.Evis Allushi
- 6.Dikens Bushaj
- 7.Anxhela Shenaj
- 8.Refie Laze
- 9.Erëmal Arapi
- 10.Arjan Isufi
- 11.Alta Haluci
- 12.Atird Hoxha
- 13.Marsela Dashi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 5/1 – 1 , datë 29.04.2025.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Meqenëse kuorumi është i mjaftueshëm, vijojmë me shprehjen e ligjshmërisë për VKB Nr 22 – 26 të mbledhjes datë 27.03.2025(Lexon shkresën e ardhur nga Prefekti i Qarkut Vlorë), ku vendimet kanë karakter individual dhe të ligjshëm nga Prefekti i Qarkut Vlorë.

Z.Gjergji Nika – Ishte një vendim, për një zë, për investimet, mund të na qartësoni.

Z.Daut Zëraj – E ka shprehur të ligjshëm.

Z.Gjergji Nika – Brenda ditës së nesërme duam një qartësim , për t’ia nisur KQZ..., o është i ligjshëm, ose jo .

Z.Daut Zëraj – Është shprehur i ligjshëm nga Prefekti i Qarkut.

Z.Gjergji Nika – Na duhet me e-mail ky projektvendim.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Po, do ta keni.

Votojmë Procesverbalin e mbledhjes së këshillit, datë 27.03.2025.

Votohet.

Pro – 32 vota

Kundër – 1 votë(Z.Gjergji Nika)

Abstenim – 0 vota

Miratohet.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë për miratim rendin e ditës.

Votohet.

Pro – 32 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 5/1 – 2 , datë 29.04.2025.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 1 e rendit të ditës, projektvendimi ”Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e bashkisë për muajin Mars 2025”.
Kalojmë në votim?

Votohet.

Pro – 33 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 5/1 – 3 , datë 29.04.2025.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 2 e rendit të ditës, projektvendimi ”Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Mars 2025”.

Votohet.

Pro – 33 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 5/1 – 4 , datë 29.04.2025.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 3 e rendit të ditës, projektvendimi “Për Miratimin e Tavanëve Përgatitorë të të Ardhurave dhe Shpenzimeve për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026 – 2028”.

Z.Kozma Mali – Projektvendimi , për miratimin e tavanëve për 2026-2028, lidhet me parashikimin e shpenzimeve të PBA 2025-2027, duke parashikuar të ardhurat për vitin 2026-2028, lidhet me PBA 2026-2028. Bazuar në Udhëzimin Nr 23/2018 si dhe Nr 8/2025. Bashkia Vlorë, është bazuar në planin strategjik si, në turizëm etj..

Tavanët e paraqitur , bazuar në mesataren e 3 viteve të fundit si dhe Buxhetin e Bashkisë Vlorë për vitin 2025.

Transferrat e pakushtëzuara, 877 milion ...

Për taksat dhe tarifat , parashikohet një rritje , referuar ndryshimeve në Paketën Fiskale .

Vendosja e këtyre tavanëve ...nga të ardhurat, nga grantet specifike dhe të pakushtëzuara ...

Kërkojmë nga ju, miratimin e këtij projektvendimi.

Znj.Eda Begaj – Mbrojtja nga zjarri dhe emergjencat civile, pse vjen ky zë, vjen në ulje si fond.

Z.Kozma Mali – Nuk është i ulur. Kjo i referohet nga të ardhurat tona, pjesa tjetër nga transfertat specifike.

Z.Gjergji Nika – Plani i të ardhurave për vitin 2025, 23milion euro. Realizimi në vitin 2024, 14 milion .

Si do shkoni nga 14 në 23 milion , është afro 60% për të kaluar.

Si do ta arrini këtë vlerë?

Z.Kozma Mali – Kjo shifër, do arrihet realizimi 100% , pasi nga Drejtoria e Urbanistikës, kemi pas hyrje si dhe nga taksat dhe tarifat vendore.

Z.Gjergji Nika – Edhe vitin e kaluar kështu keni thënë. Nëqoftëse s’keni informacion të qartë, mos i thuaj.

Z.Myzafer Elezi – Një pyetje. Tek arsimi bazë, ka rënie drastike. Artikulli 602...lexon., ka ndonjë shpjegim.

Z.Kozma Mali – Sepse janë investime. Disa nga këto projekte, disa nga këto fonde do ti marrim nga shpenzimet operative.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në votim.
Votohet.
Pro -33 vota
Kundër – 0 vota
Abstenim – 0 vota
Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 5/1 – 5 , datë 29.04.2025.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 4 e rendit të ditës, projektvendimi “Për Miratimin e Marrëveshjes për Pagesën me Këste të Detyrimeve të Prapambetura , për Taksën e Ndriçimit, Pastrimit , Gjellbërimit si dhe Taksës së Pasurisë për Kategorinë Familje , të Agjentit “Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime “ Vlorë”.

Ishte pikë e mbartur , ka qenë një kërkesë për një shtesë për kamatvonesat.

Z.Dorian Demiri – Flitet për një detyrim që Ndërmarrja e Ujësjiellësit i ka Bashkisë Vlorë. Kemi menduar të lidhim marrëveshje për principalin dhe, kamatvonesat ata nuk i njohin.

Kemi shtuar Nenin 11, lexon ...dhe as heqjen dorë ...Pra lidhja e marrëveshjes mos të falte gjokat për kamatvonesat.

Z.Myzafer Elezi – Një pyetje. Kjo marrëveshje është në kundërshtim me Ligjin Nr 48/2014. Mos të anashkalohet ky ligj, Neni 13 i tij parashikon ...lexon..., në lidhje me kamatvonesat. Ky është i paligjshëm. Ligji e thekson, kur nuk përfshihet kamatvonesa, është i paligjshëm. Projektvendim është i pavlefshëm.

Z.Dorian Demiri – Po e interpretoni keq.Neni 6, i kemi përcaktuar ..lexon., I kemi të përfshira penalitetet sipas ligjit që ju përmendët.

Z.Gjergji Nika – Keni ngritur një grup punë. Çfarë ka analizuar , se nëqoftëse, Ujësjiellësi nuk i pranon kamatvonesat . Tek shkresa në datën 4 Mars ...lexon., nuk është e vërtetë. Këshilli i Administrimit i është drejtuar ...

-Subvencion...Si mundet Këshilli i Administrimit të bëjë subvencion...

-Çfarë shpreh ky vendim, Vendimi Nr 4..detyrimi është shtytur..Në letrën që i drejtohet Drejtorisë së Ujësjiellësit, ka devijime të realitetit. Realiteti nuk është ky. Prandaj dua që grupi i punës të bëjë analizë..

Z.Dorian Demiri – Nëqoftëse, keni pakënaqësira për procedurën e Ujësjiellësit, drejtojuni Ndërmarrjes së Ujësjiellësit.

Z.Gjergji Nika – Unë nuk i drejtohem Ujësjiellësit , por Këshillit Mbikqyrës. Por grupi i punës, çfarë analize ka bërë .

Z.Dorian Demiri – Bashkia ka ngritur një Urdhër pune, për të përcaktuar vlerën e detyrimit. Është vlerësuar e gjithë procedura deri në vitin 2023. Në vitin 2024 ka paguar. Është kontabilizuar i gjithë detyrimi , vlera e interesit është 261 milion. Proçedurat e Ujësllësit, janë të tyre.

Z.Gjergji Nika – Ju më sillni materialin me një vlerë 190 milion. Ku janë 70 milion ? Ligji, kur bëhet marrëveshja ...

Z.Dorian Demiri – Ligji që theksoi zoti Elezi , ka të bëjë me faktin në Nenin 6, ka penalitetet, e kemi përcaktuar. Kë ligj kemi bërë llastik? Janë të pabazuara .

Z.Gjergji Nika – 800 mijë euro që duam ti falim Ujësllësit.

Z.Dorian Demiri – Nuk po i'a falim.

Z.Gjergji Nika – Grupi i punës, çfarë analize ka bërë?

Z.Dorian Demiri – Ka bërë kontabilizim, 190 milion plus penalitetet.

Z.Myzafer Elezi – Neni 13 i Ligjit Nr 48/2014, lexon....çdo marrëveshje ...Është e papranueshme, jo ligjore, nuk mund të ketë miratimin tim. Vota ime është kundër.

Z.Geron Gunbardhi – Ky është një debat që, zoti Gjergji ka të drejtë, por duhet dhe një falënderim për administratën që ka hap rrugë për këtë borxh. Nuk u morrën vesh, ku shkuan këto 2 milion. Kamatvonesa duhet të ishte theksuar, se do shkosh në gjykatë..Tek pika 3 që do ti drejtohesh gjykatës ..., do përcaktuar, Gjykatës së Rrethit Vlorë. Kjo marrëveshje ishte mirë të rregullohej. Ne propozuam, ne thamë të shtohet 2 vjet dhe Ujësllësit ti pjestoheshin ...Gjithë ky borxh , ta dimë të gjithë që taksat e qytetarëve do kthehen në investime.

Z.Ervis Moçka – Mendoj që, të gjithë kemi bonsensin për të gjetur mënyrën për të marrë këtë borxh. Jemi kredimarrës. Është ngritur grupi i punës . Është bërë marrëveshja me Ujësllësin , ai nuk pranon kamatvonesat , gjobat.. Pra, pranojnë sot që, ata të paguajnë . Sot ka ardhur një nen shtesë...Neni ..lexon...Proçedura e administratës do të thotë , që mund të bëhen ..pra, të pranojnë sot marrjen e principalit 190 milion dhe më vonë ...Pra, them, sot të kalojmë principalin, të marrim këto që janë ...Neni 11 që ka sjellë sot Drejtori Juridik , thotë që nuk heq dorë ...çfarë do bëhet me kamatvonesat dhe, më vonë negociojmë .

Nëqoftëse, keni një riformulim më të mirë , por ju thoni, o të gjitha sot, o në gjyq. Vetëm këtë po propozoni. Zoti Geron propozoi shumë qartë , por nuk e pranon Ujësllësi.

Z.Ermal Dredha – Përsa i përket Ndërmarrjes së Ujësllësit, ka pas ngacmime nga opozita në lidhje këto lekë të Ujësllësit.

Jemi ulur, kemi bërë një marrëveshje . Varet dhe nga mundësitë financiare të ndërmarrjes. Është ngritur grupi i punës . Kamatonesën AKUM-i nuk e ka njohur fare. Për të qenë korrekt me këtë , kemi bërë kontratë. Pra, të marrim njëherë këto dhe më vonë negociojmë përsëri.

Z.Gjergji Nika – Gabimin e keni ju si bashki. Kam shkarkuar bilancin nga QKR. Me një vendim, Ju si Kryetar Bashkie, keni miratuar analizën financiare. Ujësllësi ka paguar 750 mijë lekë për punonjësit , të prapambetura. Pra jeni , Ju keni bërë një gabim që 191 milionëshi është pa kamatvonesë.

Z.Dorian Demiri -Nuk shënohet kamatvonesa në pasqyrë financiare.

Z.Gjergji Nika – Në bilancin e vitit 2023, zoti Kryetar, keni dhe një zë tjetër.

Në vitin 2021...lexon.. , dhe për ta rregulluar këtë vlerë ..., e keni shënuar 71 milion..

Zoti Sekretar , dua një përgjigje .

Z.Ervis Moçka – Jemi sot për të diskutuar për marrëveshjen. Po diskutimi i zotit Gjergji , e ndërlikoi kaq shumë.. Kjo është marrëveshje e thjeshtë, kanë kaluar ...Drejtori Juridik, thotë që në ato pasqyra nuk shkruhet kamatvonesa.

Zotërinj, a keni ndonjë propozim konkret ?

Z.Myzafer Elezi – Zoti Moçka , është dakort me ne në thelb. Ne nuk mund të falim kamatvonesën. Me dy standarte, punon Ujësjiellësi ?

Propozim konkret. Të përfshihet në marrëveshje dhe kamatvonesa.

Z.Illir Aliaj – Nuk bëhet fjalë për falje të kamatvonesës. Ndërmarrja e Ujësjiellësit, thotë që, do paguajë principalin..Nëqoftëse, do paguajë dhe principalin dhe kamatvonesën, për ti shpëtuar këtij fenomeni , do paguajë principalin, do ngrijë kamatvonesën, pra e kanë shtrirë në kohë. Prandaj është bërë dhe Neni 11, nuk falen kamatvonesat, do shlyhen. Jam dakort që ky projektvendim të hidhet në votim.

Znj.Elpinijë Mërkuri – Kalojmë në votim.

Pro – 28 vota

Kundër – 9 vota

Abstenim ...

Z.Gjergji Nika – Është e jashtëligjshme.

Z.Geron Gunbardhi – Vota ime është pro, ju e merrni kundër.

Është një hap para. Po diskutonim të japim votat pro dhe po, pika për kamatvonesën të shtohet.

Z.Ervis Moçka – Këtë po diskutojmë . Herën e kaluar që nuk ishte parashikuar kamatvonesa, e kthyem dhe ne. Sot është shtuar dhe pjesa e kamatvonesës.

Znj.Elpinijë Mërkuri – Vota juaj zoti Gunbardhi, për atë projektvendim, është pro apo kundër ?

Z.Geron Gunbardhi – Me dhunë është kundër.

Z.Gëzim Çapoj – Këto mbledhje po kthehen në pazare.

Jemi anëtarë të Këshillit të Bashkisë me të drejta të barabarta. Unë ju dëgjoj kur diskutoni. Parashtrohet projektvendimi, diskutohet dhe, kush është pro e kush është kundër . Kur ka argumenta , ne i kemi projektvendimet.

Z.Klodian Xhyheri – Unë e kisha për procedurë, në lidhje me votimin. Dua të kthehet dhe njëherë votimi. Dashur pa dashur bëhet një falsifikim.

Z.Gëzim Çapoj – Edhe unë jam dakort, të bëhet votimi dhe njëherë.

Znj.Elpinijë Mërkuri – E hedhim dhe njëherë në votim pikën 4, sipas propozimit të administratës. Votohet.

Pro – 33 vota

Kundër – 5 vota

Abstenim – 1 votë

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 5/1 – 6 , datë 29.04.2025.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 5 e rendit të ditës, projektvendimi “Për Miratimin e Listës Përfundimtare (Të pjesshme)të Pronave të Paluajtshme Publike , Shtetërore që Transferohen në Pronësi ose në Përdorim të Bashkisë Vlorë, të Qarkut të Vlorës “.

Z.Jovan Jaupaj – Me VKM Nr 1643/2008, i është miratuar Bashkisë Vlorë lista e pronave shtetërore. Me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Nr 371 është ngritur grupi i punës . Janë bërë hartat për çdo objekt. Është bërë dhe aplikimi në ASHK, për transferimin e objekteve të mësipërme në pronësi të bashkisë. Në relacion janë detajuar të gjitha pronat , bazuar në Ligjin Nr 20/20, ku janë paraqitur 51 objekte.

-Ka ndryshime të numrave të pasurive ;

-Sipërfaqet e objekteve dhe truallit kanë ndryshuar ;

-Në njësitë administrative janë të pamenaxhuara;

-Ka dhe një gabim midis hartave nga ASHK dhe Legalizimeve .

Ne vazhdojmë punën deri në certifikim të këtyre pronave . Kërkojmë nga ju miratimin e këtij projektvendimi, për vazhdimin deri në hallkat e tjera.

Z.Simo Petromilo – Pjesa jugore e Shkollës “Ali Demi”, është shpronësuar një pjesë e truallit, por shoh që janë hedhur plindat.

Z.Jovan Jaupaj – Pjesa që diskutojmë , është një inventar publik .

Bazuar në Vendimin 20/20, të gjitha pronat kanë pësuar ndryshime, ne bëjmë gjendjen faktike.Kjo nuk përfshihet në sipërfaqen e shkollës.

Z.Besmir Brahimi – Pra, po ecni me gjendjen faktike.

Z.Jovan Jaupaj – Po, sipas ligjit.

Z.Besmir Brahimi – Po ata që kanë uzurpuar , do ti lëmë ?

Z.Jovan Jaupaj – Nëqoftëse e kanë me dokument, s’kemi çtë bëjmë.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në votim ?

Z.Gjergji Nika – Po kalohet nga shtet në bashki ?

Z.Jovan Jaupaj – Listat paraprake, kemi për 51 objekte, gjithë dokumentacioni nga ASHK-ja.

Z.Gjergji Nika – Letrat , me gjendjen faktike. A do ti merrni dokumentat ligjorë me faktiken ?

Znj.Alma Xhema – Problemet teknike që kanë hartat . Nëqoftëse i përputh , kanë ndryshime. Hartat e KRGJSH janë hartat që punon Aluizni.

Ky proces me gjendjen faktike me Aluiznin. Pra, sot është kufiri real. Kufiri është ky që po bëhet sot me Aluiznin. Nëqoftëse në inventar ka ndryshime, mirë është që, ky proces të fillojë. E gjithë kjo do shkojë në Tiranë . Grupin e parë e kemi përfshirë. Do vazhdojmë me qendrat shëndetësore, pastaj me institucionet.

Z.Jovan Jaupaj – Është një proces...

Znj.Alma Xhema – Çdo kufi, do azhurnohet me ASHK.

Z.Jovan Jaupaj – Pasi të kalojë më VKM...flas për objektet

Z.Klodian Xhyheri – Institucionet, nuk kanë të njëjtat harta. Ne marrim gjendjen faktike, jo juridike. Mendoj që, duhet të ecim me gjendjen juridike. Është ligji.

Znj.Elca Bezhani – Atje ku kanë marrë certifikatat, në objektet arsimore, nuk i zhbëjmë dot.

Znj.Edlira Kapllanaj – Më vjen mirë që, të gjitha pronat ti kalojnë bashkisë.

Gjimnazi i ri pranë “Ibrahim Kushtës”, nuk është në listë .

Znj.Alma Xhema – Është në listë.

Z.Sokol Kushta – Më vjen mirë, për nisjen e këtij procesi. Keni filluar me pronat sportive ?

Z.Jovan Jaupaj -Do vazhdojmë me shkollat, qendrat shëndetësore, institucionet sportive. Janë gjithësej 11 fusha.

Z.Sokol Kushta – Janë bërë disa aktivitete sportive. Mos bie e ndesh , tek fusha mbrapa tek stadiumi , meqenëse ka investime ?

Znj.Alma Xhema – Do vazhdojmë me pronësi, është tokë shtet .

Znj.Edlira Kapllanaj – Tu lihet vend dhe për strehimin social.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në votim.

Pro – 36 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 5/1 – 7 , datë 29.04.2025.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 6 e rendit të ditës, projektvendimi “Për Miratimin e Marrëveshjes Operacionale Ndërmjet Bashkisë Vlorë dhe Shoqatës ” TID” Vlorë për Modelin “BID”.

Z.Dorian Demiri – Projektvendimi ka si synim miratimin e marrëveshjes operacionale , midis Bashkisë Vlorë dhe Shoqatës “TID”.

Ligji Nr 63/2020 tregon mënyrën e funksionimit. Në muajin Mars 2024 nga Shoqata “BID” u morr autorizimi nga Bashkia Vlorë..ku këtu nënkuptohet përmirësimi i marrëdhënieve midis bizneseve, pastrimin, zhvillimin e aktiviteteve etj.

Ne kemi dhënë autorizimin.

Zona “TID” shtrihet që nga karburanti tek posta, deri tek banka.Nga ana e propozuesit , janë votuar nga të gjitha bizneset në këtë zonë .

Bashkia , gjithë financimi është në vlerën 48 milion lekë/reja, ku;

-4,5 milion nga bashkia.

-3,2 milion nga vetë subjektet .

-33 milion fondi nga “TID”.

Projekti, prospekti “BID”(Zona e investimeve në biznes), pra nga “TID”.

Z.Ardian Musta – A ka ndonjë informacion apo relacion të aktivitetit të Shoqatës “TID”?

Z.Dorian Demiri – Këtu nuk kam, me shifra nuk e kam por aktualisht .., sepse s’ka filluar.Patjetër që ka, por se kam momentalisht.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Vijani në dispozicion materialin këshilltarit.

Z.Simbol Pazaj – Mbështes mendimin e zotit Musta . Meqenëse, s’ka një informacion them ta shtyjmë.

Z.Dorian Demiri – Është bërë ligji, është detyrim i pushtetit vendor. Përveç investimit të qeverisë..... Sipas parashikimit të ligjit , është i vetmi subjekt që ka parqitur kërkesën . Në Mars 2024 , i kemi dhënë autorizimin.

Z.Simbol Pazaj – Çfarë ka bërë ?

Z.Dorian Demiri – Tek marrëveshja , është i gjithë plan biznesi. I kemi diskutuar kush janë përfitimet . Jemi koshientë se sa është zhvilluar zona.

Z.Gjergji Nika – Jam dakort me këtë projektvendim. Le të na vijë më vonë materiali.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në votim.

Votohet .

Pro – 30 vota

Kundër – 3 vota

Abstenim – 0 vota

1 anëtar pa votuar.

Miratohet .



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 5/1 – 8 , datë 29.04.2025.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 7 e rendit të ditës, projektvendimi “Për Përcaktimin e Përfaqësuesve të Bashkisë Vlorë, në Bordet e Institucioneve Arsimore Publike dhe Jo Publike”.

Kalojmë në votim.

Votohet.

Pro 32 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota; 1 anëtar pa votuar.

Miratohet .



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 5/1 – 9 , datë 29.04.2025.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 8 e rendit të ditës, projektvendimi “Për Miratimin e Vlerës Financiare të Dëmeve të Shkaktuara nga Djegia e Banesës së zotit Fiqiri Rrapaj dhe Shpërblimin Financiar nga ana e Bashkisë Vlorë “.

Votohet.

Pro – 33 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 5/1 – 10 , datë 29.04.2025.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 9 e rendit të ditës, projektvendimi “Për Miratimin e Vlerës Financiare të Dëmeve të Shkaktuara nga Djegia e Banesës së zotit Arqile Gjini dhe Shpërblimin Financiar nga ana e Bashkisë Vlorë “.

Votohet.

Pro – 33 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 5/1 – 11 , datë 29.04.2025.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 10 e rendit të ditës, projektvendimi “Për Miratimin e Vlerës Financiare të Dëmeve të Shkaktuara nga Djegia e Banesës së zonjës Ornela Sejdia dhe Shpërblimin Financiar nga ana e Bashkisë Vlorë “.

Votohet.

Pro – 33 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 5/1 – 12 , datë 29.04.2025.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 11 e rendit të ditës, projektvendimi “Për Miratimin e Vlerës Financiare të Dëmeve të Shkaktuara nga Djegia e Banesës së zonjës Margarita Elezi dhe Shpërblimin Financiar nga ana e Bashkisë Vlorë “.

Votohet.

Pro – 33 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 5/1 – 13 , datë 29.04.2025.

Znj.Elpiniki Mërkuri – Pika “Të ndryshme”.

Znj.Eda Begaj – Kur mund të shtojmë një linjë urbane në rrugën Transballkanike dhe stacion autobuzi?

Z.Daut Zëraj – Do i’a kalojmë administratës.

Znj.Eda Begaj – A mund të vihet ndonjë tabelë, një njoftim për zhvillimin e punimeve që kryhen ? Punime po bëhen, jam shumë falënderuese, por minimalisht të vendoset një tabelë, një informacion.

Znj.Elca Bezhani – Në mbështetje të zonjës Begaj, në lidhje me trafikun e ngarkuar. Çfarë masash do marrë bashkia në lidhje me punimet, me devijimet që po bëhen ?

Morra kontakt me administratën dhe më thanë që do ta sjellin këtë informacion.

-Doja një konfirmim në lidhje me mbetjet urbane dhe çfarë zgjidhje do tju jepet banorëve , strukturave akomoduese që i kanë pranë banesave të tyre. Ju lutem , Bashkia të jetë në korrent për ta rregulluar mirë këtë situatë.

Znj.Irena Toshkallari – Përsa i përket investimeve , janë investime të Bashkisë Vlorë dhe të institucioneve të tjera, do të jetë në vëmendjen e administratës për publikimin e orareve nga Drejtoria e Ujësjellësit.

-Vendgrumbullimet , do të hiqen nga një strukturë akomoduese por duhet dhe mirëkuptimi nga ana e banorëve për tu vendosur në një vend tjetër.

Znj.Elca Bezhani – Kryetarët e rajoneve ...A e kanë kapacitetin e nevojshëm rajonet për përballimin e kërkesave dhe nevojave të banorëve?

Znj.Irena Toshkallari – Nëqoftëse, nuk bashkëpunojnë qytetarët, atëherë asnjëherë nuk janë të mjaftueshme burimet njerëzore .

Znj.Elca Bezhani – Ka nevojë më shumë për menaxhim. Mendoj të ketë bashkëpunim me ndërmarrjet e tjera.

Z.Sokol Kushta – Vlorë në dy sezonet, nuk është e barabartë. Po sikur të gjeni një mundësi për punonjës sezonalë?

Znj.Irena Toshkallari – Për zonën e plazhit, vjen një firmë private e Agjencisë së Bregdetit.

Z.Sokol Kushta – Firma do iki..

Znj.Irena Toshkallari – Është shoqëri private nga Agjencia e Bregdetit.

Z.Sokol Kushta – Në lidhje me qarkullimin dhe administratorët e pallateve, i shikoni si pjesën tuaj.

Znj.Irena Toshkallari – Kryetari e ka theksuar , për administratorët, 50% nga Bashkia dhe 50% nga banorët. Është nismë e Kryetarit të Bashkisë. Kryetari i Bashkisë ka bërë seanca ndërgjegjësimi me banorët.

Znj.Rajmonda Zoto – Segmenti nga “Vetshërbimi” deri tek Spitali , gjithmonë është i bllokuar. Të gjithëve na ka rënë në sy. Është e njëjta gjë. Duhet shtrënguar masat, ajo korsi duhet të jetë e liruar.. Institucionet të jenë pak më të përgjegjshme.

Z.Klodian Xhyheri – Më keni kthyer dy përgjigje nga NSHP...lexon..kjo është përgjigja?

Z.Daut Zëraj -Po, ajo është përgjigja.

Z.Klodian Xhyheri – Zona e Kalasë ka nevojë për një investim të mirëfilltë.

Z.Daut Zëraj – Është objekt për tu trajtuar , por më mirë në fund të viti, për në buxhet.

Z.Klodian Xhyheri – Në lidhje me kangjellat në Varrezat Publike..Ky s’është vetëm një ankesë , problem, ka dhe disa rrugica.

-Tek “Moli i Naftës”, muri i vjetër mund të bjerë dhe të zërë ndonjë.

-Pallatet e Gorrishtit , ujë s’kanë , tubacionet skandal, ndriçim, jo. Sa të keni mundësi për rehabilitim .

-Shesh për fëmijët, jo.

Pallatet e Gorrishtit , tek KSHA.

-Rruga “Remzi Ramo”, në lagjen Çole, pas mapos.

Znj.Irena Toshkallari – Sa të mbarojë Ujësjiellësi punimet , do të kthehen në gjendjen e mëparshme.

Z.Klodian Xhyheri – Ajo rrugë nuk është shtruar asnjëherë.

Znj.Irena Toshkallari – Do tju kthejmë përgjigje me shkrim.

Z.Klodian Xhyheri – Stacioni ndërqytetas, s’kam marrë përgjigje.

Z.Geron Gunbardhi – Një pyetje. Subjektet që posedojnë skafet dhe gomonet ...Nuk po gjendet mirëkuptim midis Bashkisë, Postës Kufitare dhe Kapitenerisë. Nëqoftëse, Bashkia Vlorë bën një takim me këto biznese ..

-Me këto trekëndëshat në qytet, ka shumë aksidente .

Z.Gjergji Nika -Të nderuar qytetarë. Jemi tek pika, Të ndryshme.

Z.Besmir Brahimi – Jemi këtu për debat, të marrim më të mirën.

Kontratën me KWF, me Ujësjiellësin, mund të na i vini në dispozicion ?

Nuk lihen rrugët ashtu. Ka 2 vjet kjo gjendje.

-Votuar parkimet..të vazhdonin vijëzimet..trafiku..

-Kontratën me Ujësjetllësin dhe çfarë është bërë me Drejtorinë e Parkimeve ?

-Nga 1 Korrik – 31 Gusht, makinat që lëshojnë inerte rrugës , të marrin gjobën.

Z.Klodian Xhyheri – Kam bërë një kërkesë për tecet lundruese. Mu përgjigjini.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Faleminderit gjithë këshilltarëve .